

## UJËRAT E PËRMBYTJES DHE RREZIKU PËR SHËNDETIN TONË

Pas një emergjence natyrore si përmbytja, uji që mbetet pas dhe ujërat e ndenjura mund të jenë të rrezikshme për shëndetin dhe mund të ndikojnë në shfaqjen e sëmundjeve infektive, si dhe lëndimeve të ndryshme... Mbroni veten dhe të dashurit tuaj nga rreziqet që sjellin përmbytjet!

**Qëndroni larg ujit të përmbytjes.**

**Ujërat e përmbytjeve bëhen të rrezikshme dhe mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve pasi ato mund të përmbajnë:**

- Mikroba dhe ndotës të tjerë që mund të çojnë në sëmundje.
- Objekte fizike, si: lëndë druri, automjete dhe mbeturina.
- Mbetjet e rrezikshme shtëpiake, mjekësore dhe industriale.
- Mbetjet njerëzore dhe blegtorale.
- Linjat e energjisë elektrike të prishura.
- Kafshët e egra ose endacake, si brejtësit dhe gjarpërinjtë.

**Ekspozimi ndaj ujit të kontaminuar nga përmbytjet mund të shkaktojë:**

- Infeksione të plagëve;
- Skuqje të lëkurës;
- Sëmundje gastrointestinale;
- Tetanosi etj.

**Është e rëndësishme të mbroheni nga rënia në kontakt me ujin e përmbytjes. Por**

**KUJDES!** – Nëse bini në kontakt me ujërat e përmbytjeve:

- Lani zonën me sapun dhe ujë të pastër ose përdorni peceta me bazë alkooli, ose dezinfektues sa më shpejt të jetë e mundur.
- Kujdesuni për plagët dhe kërkoni kujdes mjekësor nëse është e nevojshme.
- Lani rrobat e kontaminuara me ujërat e përmbytjeve në ujë të nxehtë dhe detergjent përpara se t'i ripërdorni.

**Nëse duhet të futeni në ujërat e përmbytjeve, vishni çizme gome, doreza gome dhe syze.**

**Parandaloni lëndimet.**

Uji i përmbytjes mund të përmbajë objekte të mprehta, të tilla si: pjesë xhami ose metali që mund të shkaktojnë lëndime dhe të çojnë në infeksion. Ndhurma e shpejtë mund të ndihmojë në shërimin e plagëve të vogla dhe parandalimin e infeksionit.

**Parandaloni infeksionin e plagëve të hapura dhe skuqjeve.**

Plagët e hapura dhe skuqjet nëse ekspozohen ndaj ujit të përmytjes mund të infektohen.

- Shmangni ekspozimin ndaj ujit të përmytjes, nëse keni një plagë të hapur.
- Mbuloni plagët e pastra dhe të hapura me një fashë të papërshkueshme nga uji për të zvogëluar mundësinë e infeksionit.
- Mbani plagët e hapura sa më të pastra duke i larë mirë me sapun dhe ujë të pastër.
- Nëse një plagë fillon të skuqet, ënjtet ose ka rrjedhje, kërkoni kujdes mjekësor të menjëhershëm.
- Kërkoni kujdes mjekësor sa më shpejt të jetë e mundur nëse ka një objekt të huaj (dhe, dru, metal ose objekte të tjera) të ngulitura në plagë.

### **Mbrohuni nga sëmundjet e diarresë**

Duhet të dini se uji i përmytjes mund të përmbajë ujëra të zeza dhe ngrënia ose pirja e çdo gjëje të kontaminuar nga uji i përmytjeve mund të shkaktojë sëmundje diarreike (si infeksioni *E. coli* ose *Salmonella*).

### **KUJDES!**

- Lani duart pas kontaktit me ujin e përmytjes. Gjithashtu, sigurohuni që të lani duart e fëmijëve me ujë dhe sapun shpesh dhe gjithmonë para ngrënies.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë në zonat e përmytjeve.
- Mos lejoni fëmijët të luajnë me lodra që janë kontaminuar nga uji i përmytjeve dhe të cilat nuk janë dezinfektuar.

### **Mbroni veten nga pickimi i kafshëve dhe insekteve.**

Uji i përmytjes mund të zhvendosë më pranë jush kafshët, insektet dhe zvarranikët. Për të mbrojtur veten dhe familjen tuaj, jini vigjilentë dhe shmangni kontaktet e padëshiruara.

### **Shmangni rreziqet elektrike brenda ose jashtë shtëpisë tuaj.**

Pas një përmytjeje ose fatkeqësie tjetër natyrore duhet të jeni të kujdesshëm për të shmangur rreziqet elektrike si në shtëpinë tuaj, ashtu edhe jashtë saj.

- Stakoni energjinë elektrike dhe mbyllni rezervuarët e gazit natyror në shtëpinë tuaj për të shmangur zjarrin, goditjet elektrike ose shpërthimet.
- **KURRË** mos prekni një linjë elektrike të rënë në ujë. Shmangni kontaktin me linjat e energjisë elektrike gjatë pastrimit.
- Mos e ngisni makinën nëpër ujërat e ndenjura nëse linjat e rrëzuara të energjisë janë në ujë.

**KUJDES... PASI NJË PËRMBYTJE MBARON, RREZIKU NUK ËSHTË LARGUAR!  
SHËNDETI I NJERËZVE ËSHTË AKOMA I CËNUAR NGA UJI I MBETUR!**